

GJYKATA E APELIT

Lënda numër: PAKR NR. 39/2015

Datë: 5 prill 2016

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Elka Filcheva-Ermenkova si kryetare kolegji dhe gjyqtare raportuese, Piotr Bojarczuk gjyqtar i EULEX-it dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit të Kosovës Fillim Skoro si anëtar të trupit gjykues, me ndihmën e Vjollca Kroci-Gerxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it, dhe mbajtëse e procesverbalit, në lëndën penale kundër të pandehurve në vijim:

I.H.1, emri i babës xxx emri i nënës xxx, lindur me datë xxx në xxx, me banim në rrugën xxx, shqiptar i Kosovës, i martuar;

Sh.H.2, emri i babës xxx, emri i nënës xxx, lindur me datë xxx në xxx xxx, me banim në rrugën 'xxx 153, shqiptar i xxx, i martuar, xxx;

N.Q., emri i babës xxx, emri i nënës xxx, lindur me datë xxx në xxx, me banim në rrugën xxx në xxx, shqiptar i xxx, i martuar;

S.S., emri i babës xxx, me nofkën xxx, emri i nënës xxx, lindur me datë xxx në fshatin xxx, xxx, me banim në xxx, xxx, xxx i Kosovës,

Që të gjithë të akuzuar përmes Aktakuzës së ngritur me datë 13 nëntor 2013 nga ana e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si në më poshtë:

1. I.H.1: Krime Luftë kundër Popullatës Civile e parashikuar dhe e dënueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, shtesë Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të gjitha rregulloret e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës që ka të bëjë me aktakuzën, i pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së, në bashkë kryerje me N.Q.n dhe një ushtar tjetër të UÇK-së i identifikuar si 'xxx':

- **Cenuan integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitarit A**, një femre civile shqiptare të Kosovës, më saktësisht, i pandehuri mori pjesë në këtë krim duke shfrytëzuar pozitën e tij dhe autoritetin duke e mbajtur viktimën në dispozicion

absolut të të pandehurve të veprës penale duke iu lejuar atyre që të kryejnë rrahjet; në fshatin xxx, Komuna e xxx, në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999;

- **Torturuan dëshmitarin B**, një femre civile shqiptare të Kosovës duke e rrahur atë vazhdimisht dhe duke e detyruar atë që të shkruante dhe të pranonte rrejshëm lidhur me gjoja bashkëpunimin e saj me autoritete serbe, më saktësisht, i pandehuri morri pjesë në këtë krim duke shfrytëzuar pozitën e tij dhe autoritetin duke e mbajtur viktimën në dispozicion absolut të të pandehurve të veprës penale duke iu lejuar atyre që të kryejnë veprat penale, në fshatin xxx, Komuna e M, në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999;
 - **Krime Luftë kundër Popullatës Civile e parashikuar dhe e dënueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, shtesë Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të gjitha rregulloret e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës që ka të bëjë me aktakuzën, i pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së **trajtoi në mënyrë çnjerëzore dëshmitaren A dhe dëshmitaren B duke inskenuar gjoja se ekzekutimin** me ç’ rast i pandehuri i shtinte viktimat që të binin në gjunjë dhe pastaj shkrepnin të shtëna armësh prapa shpinës së tyre, në një vend të papërcaktuar mes fshatrave të V. dhe L., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999.**
2. **Sh.H.: Krime Luftë kundër Popullatës Civile e parashikuar dhe e dënueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, shtesë Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të gjitha rregulloret e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës që ka të bëjë me aktakuzën, i **pandehuri përdhunoi dëshmitaren A**, një femër civile, shqiptare e Kosovës e paraburgosur në duart e UÇK-së, duke pasur marrëdhënie seksuale me të kundrejt vullnetit të saj, në fshatin V., Komuna e M., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999;**
3. **N.Q.: Krime Luftë kundër Popullatës Civile e parashikuar dhe e dënueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të**

Kosovës (KPK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, shtesë Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të gjitha rregulloret e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës që ka të bëjë me aktakuzën, i pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së, në bashkë kryerje me **I.H.1** dhe një ushtar tjetër të UÇK-së i identifikuar si '**H.**':

- **Cenuan integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitarit A**, një femre civile shqiptare të Kosovës, duke e rrahur atë në mënyrë të vazhdueshme me mjete të ndryshme, në fshatin V., Komuna e M., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999;
 - **Torturuan dëshmitarit B**, një femre civile shqiptare të Kosovës, duke e rrahur atë në mënyrë të vazhdueshme me mjete të ndryshme dhe duke e detyruar atë në të njëjtën kohë që të shkruante dhe të pranonte rrejshëm lidhur me gjoja bashkëpunimin e saj me autoritete serbe, në fshatin V, Komuna e M., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999;
- 4. S.S.: Krime Lufte kundër Popullatës Civile e parashikuar dhe e dënueshme** me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, shtesë Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të gjitha rregulloret e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës që ka të bëjë me aktakuzën, i pandehuri në cilësinë e tij si pjesëtar me gradë të lartë i UÇK-së, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitares A dhe B**, dy femrave civile shqiptare të Kosovës, duke i rrahur vazhdimisht ato, në L., Komuna e S, në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999.

Të gjykuar në instancën e parë nga Gjykata Themelore e Mitrovicës me Aktgjykimin nr. P. 9412013, i lëshuar me datë 29 maj 2014, si në vijim:

- 1. I akuzuari I.H.1 LIROHET** nga tri pikat e akuzës së kryerjes së veprës penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile, e paraparë dhe e ndëshkueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër

Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, plotësim i Konventave të Gjenevës së vitit 1949.

2. **I akuzuari Sh.H.2 LIROHET** në një pikë të akuzës së kryerjes së veprës penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile, e paraparë dhe e ndëshkueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, plotësim i Konventave të Gjenevës së vitit 1949.
3. **I akuzuari N.Q. LIROHET** në dy pika të akuzës së kryerjes së veprës penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile, e paraparë dhe e ndëshkueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, plotësim i Konventave të Gjenevës së vitit 1949.
4. **I akuzuari S.S. LIROHET** në një pikë të akuzës së kryerjes së veprës penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile, e paraparë dhe e ndëshkueshme me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ-së), aktualisht e ndëshkueshme sipas nenit 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së) në kundërshtim me nenin 3 i Përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës i datës 12 gusht 1949 dhe nenit 4 dhe 5 të Protokollit II i datës 8 qershor 1977, plotësim i Konventave të Gjenevës së vitit 1949.

Mu në ditën e Aktgjykimit, Gjykata Themelore e Mitrovicës lëshoi Aktvendim për ndërprerjen e paraburgimit gjyqësor për **I.H.1, N.Q.n dhe Sh.H.2.** sa i përket vetëm këtij rasti.

Duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorit Special të parashtruar me datë 27 gusht 2014 kundër Aktgjykimit Lirues të Gjykatës Themelore të Mitrovicës;

Pas shqyrtimit të përgjigjeve në vijim të avokatëve mbrojtës ndaj ankesës së PSRK-së:

- a) Të avokatit mbrojtës Gani Rexha në emër të të pandehurit **Sh.H.2**, me datë 11 shtator 2014;
- b) Të avokatit mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit **I.H.1**, dhe
- c) Të avokatit mbrojtës Bajram Tmava në emër të të pandehurit **N.Q.**.

pas shqyrtimit të propozimit të prokurorit shtetëror të apelit të parashtruar në përputhje me nenin 412 të KPP-së të datës 10 prill 2015;

duke vepruar në përputhshmëri me nenet 389, 390, 394, 398, 471 Kodit të Procedurës Penale – Ligji nr. 04/L-123 (KPP):

Mbajti një seancë publike të kolegjit të apelit me datë 5 prill 2016 dhe

Morri vendim dhe votoi me datë 5 prill 2016;

lëshon këtë

AKTGJYKIM

- **Ankesa e PSRK-së parashtruar me datë 27 gusht 2014 kundër Aktgjykimit P. nr. 941/13 të Gjykatës Themelore të Mitrovicës të lëshuar me datë 29 maj 2014, pjesërisht Pranohet;**
- **Aktgjykimi P. nr. 941/13 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës i lëshuar me datë 29 maj 2014, sa i përket të pandehurit I.H.1 për veprën penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile, do të thotë cenimit të integritetit trupor dhe shëndetit të dëshmitares A dhe torturimit të dëshmitares B, konfirmohet;**
- **Aktgjykimi P. nr. 941/13 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës i lëshuar me datë 29 maj 2014, sa i përket të pandehurit N.Q. për veprën penale Krime Lufte kundër Popullatës Civile, do të thotë cenimit të integritetit trupor dhe shëndetit të dëshmitares A dhe torturimit të dëshmitares B, konfirmohet në tërësi;**
- **Aktgjykimi P. nr. 941/13 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës i lëshuar me datë 29 maj 2014 në pjesën sa i përket përfshirjes së të pandehurit I.H.1 në ekzekutimin e inskenuar, anulohet dhe lënda kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.**
- **Aktgjykimi P. nr. 941/13 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës i lëshuar me datë 29 maj 2014 në pjesën që ka të bëjë me të pandehurit S.S. dhe Sh.H.2 anulohet dhe lënda kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.**

ARSYETIM

1. Ecuria Procedurale Relevante

Aktakuza PP 07/13 e datës 13 nëntor 2013 u parashtrua nga ana e PSRK-së të njëjtën ditë dhe akuzoi të pandehurit e sipër përmendur për shkeljet siç u përshkruan më sipër. Seanca dëgjimore fillestare u mbajt me datë 13 dhjetor 2014.

Që nga fillimi i hetimeve deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor janë lëshuar një numër urdhëresash për paraburgim si dhe Vendime tjera, Urdhëresa dhe Aktvendime të marra nga gjykata.

Të pandehurit **I.H.1** dhe **N.Q.** janë mbajtur në paraburgim që nga data 25 shtator 2013. I pandehuri **S.S.** është duke u mbajtur në paraburgim që nga data 31 maj 2013 në një proces tjetër penal gjyqësor (lënda penale P 938/13 para GjTh të Mitrovicës. I pandehuri **Sh.H.2** është duke u mbajtur në paraburgim që nga data 20 qershor 2013¹.

Seancat dëgjimore të shqyrtimit gjyqësor të hapura ndaj publikut u mbajtën me datë 14 prill 2014 dhe me datë 07, 08 maj dhe pjesërisht me datë 19 maj 2014, dhe në seanca të mbyllura me datë 22, 23, 24, 25 prill 2014, dhe me datë 6 maj 2014 dhe pjesërisht me datë 19 maj 2014.

Që nga fillimi i hetimeve deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor janë lëshuar një numër urdhëresash për paraburgim si dhe Vendime tjera, Urdhëresa dhe Aktvendime të marra nga gjykata.

Me datë 29 maj 2014, Gjykata Themelore në Prishtinë lëshoi Aktgjykimin Lirues për lëndën P. nr. 941/13.

Në të njëjtën ditë të Aktgjykimit, Gjykata Themelore e Mitrovicës lëshoi Aktvendim mbi ndërprerjen e paraburgimit për **I. H.1, N.Q. dhe Sh.H.2** vetëm sa i përket kësaj lënde.

¹ Aktvendimi i Gjykatës së Apelit PN 109/14, 6 mars 2014

2. AKTGJYKIMI I KUNDËRSHTUAR

Me datë 29 maj 2014, Gjykata Themelore e Mitrovicës lëshoi Aktgjykimin e saj në lëndën P. nr. 941/13, duke i shpallur të gjithë të pandehurit të pafajshëm për veprat penale për të cilat ngarkohen me Aktakuzë.

3. PARASHTRESAT E PALËVE

Ankesa e PSRK-së

Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PSRK-ja parashtrroi ankesë me datë 27 gusht 2014. Ankesa e prokurorit është parashtruar në kohë dhe në përputhje me nenin 380 (1) të KPP-së.

PSRK-ja në ankesën e vet e kundërshton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Mitrovicës për shkak të:

- a) Shkeljes esenciale të KPP-së, do të thotë shkeljes së nenit 383 (1) 1.1) lidhur me nenin 384 të KPP-së, dhe
- b) Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, do të thotë shkeljes së nenit 383 (1) 1.3) lidhur me nenin 386 të KPP-së.
- c) Përpos kësaj, në bazë të nenit 408 (3) të KPP-së, PSRK-ja kundërshton po ashtu Aktvendimin e gjykatës më datë 22 prill 2014 lidhur me identifikimin brenda në sallën e gjykimit.

a) Shkeljet esenciale të KPP-së

Sa i përket shkeljeve esenciale të KPP-së, do të thotë shkeljes së nenit 383 (1) 1.1), PSRK-ja paraqet se Aktgjykimi nuk është hartuar në përputhje me nenin 370 të KPP-së. Gjykata nuk ka vepruar në përputhje me këtë dispozitë pasi që nuk ka deklaruar qartazi dhe në mënyrë të tërësishme se cilat fakte u gjeten si të dëshmuara apo jo të dëshmuara sa i përket ekzekutimit të inskenuar. Gjykata nuk dha baza të mjaftueshme për të sqaruar vërtetësinë e marrëdhënies së dashurisë mes **H.2.** dhe dëshmitares A.

PSRK-ja më tej parashtron në ankesën e vet se gjetjet lidhur me përdhunimin janë paraqitur pa ndonjë arsytim të dukshëm dhe të tërësishëm. Më tej thuhet në ankesë se gjykata nuk ka vërtetuar faktin që **H.1.** ishte ushtar i rregullt duke pasur parasysh se kemi deklaratën e dëshmitarit H. I. i cili deklaroi se e dinte që **H.1.** ishte komandant në V. para dimrit të vitit 1998. Prandaj PSRK-ja i propozon Gjykatës së Apelit që të tërheq

Aktgjykimin duke e anuluar atë dhe duke e kthyer lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje.

b) Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, PSRK-ja në ankesën e vet deklaron se gjykata vërtetoi në mënyrë jo të drejtë dëshmitë që quan në lirimin e gabueshëm të katër të pandehurve. Ai kundërshton dëshmitë e identifikimit të të pandehurve në vijim:

- I pandehuri **H.1** duke thënë se gjykata e shkallës së parë nuk analizoi shumicën e provave të rëndësishme për identifikimin e të pandehurit **H.1**;
- Dëshmia e identifikimit sa i përket **S.S.** dhe **L.** duke thënë se gjykata nuk mori parasysh në mënyrë të përgjithësuar të tri aspektet e identifikimit të **S.**, do të thotë ato që kanë të bëjnë me **L.**, e dyta është përdorimi i emrave ‘**S**’ dhe ‘**S.S.**’ dhe e treta është njohja e **S.** nga mediat. Veç kësaj, gjykata është dashur që të lejoj procedurën e identifikimit brenda gjykatës për të vërtetuar identifikimin nga masmediat.

Sa i përket konfliktit të armatosur, PSRK-ja parashtron se aktgjykimi gabimisht vlerësoi dëshmitë lidhur me të pandehurin **H.2** kur thotë se ‘**H.2. veprimi për arsye personale dhe për shkak të lidhjes së tij paraprake të dashurisë me dëshmitaren A. Kjo tërësisht bie poshtë që kjo të ketë ndonjë komponentë ushtarake**’. Lidhur me këtë, PSRK-ja deklaron se nuk ekziston asnjë parakusht ligjor në Kosovë apo ndërkombëtar që të ketë komponentë ushtarake, në vend të kësaj, ekzistimi i konfliktit të armatosur është parakusht për kohën e incidentit dhe se po të mos ishte për konfliktin e armatosur incidenti nuk do të kishte ndodhur. Ai më tej parashtron se është vendosur me ligj ndërkombëtar që çdo civil, duke përfshirë këtu të pandehurin **H.2.** mund të kryej krim lufte duke pasur parasysh që përdhunimi i dëshmitares A ndodhi gjersa ajo ishte e paraburgosur në bazën e UÇK-së për atë se ajo gjoja se ishte bashkëpunëtore e Serbëve dhe se po të mos mbahej e robëruar, përdhunimi nuk do të ndodhte.

PSRK-ja më tej paraqet se gjykata nuk është e lidhur me cilësimin ligjor të prokurorit për veprat penale. Prandaj, po të jetë përkundër dëshmitëve, vlerësimi i gjykatës do kishte dëshmi të pa mjaftueshme për të dëshmuar se **Sh.H.2** kreu përdhunimin si krim të luftës, gjykata është dashtë që ta dënonte për cenim të integritetit trupor si krim i luftës. Prandaj, PSRK-ja kërkon nga Gjykata e Apelit që ta dënoj **H.2** për **krim lufte cenim i integritetit trupor** po qe se gjen se ka dëshmi të pamjaftueshme për veprën penale të përdhunimit.

c) Identifikimi brenda në gjykatë

PSRK-ja në ankesën e vet pretendon se gjykata nuk ia lejoi prokurorisë që të kryej asnjë identifikim brenda në gjykatë, posaçërisht identifikimin e **S.S.** Duke vepruar kështu, Gjykata shkeli në mënyrë të konsiderueshme nenin 384 (2) 2.1) dhe shkeli nenin 7 të KPP-së.

PSRK-ja kërkon nga Gjykata e Apelit që të pranoj ankesën e prokurorisë, të përmirësoj Aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke i dënuar që të gjithë të pandehurit për të gjitha akuzat apo, të anuloj Aktgjykimin dhe ta kthej lëndë në Gjykatën Themelore për rigjykim dhe rivendosje dhe përmbysjen e Aktvendimit të Gjykatës Themelore duke lejuar prokurorin që të bëjë identifikimin brenda gjykatës.

4. Përgjigjet e avokatëve mbrojtës ndaj ankesës së PSRK-së

Ndaj ankesave të PSRK-së, avokatët mbrojtës në vijim parashtruan përgjigje:

- Avokati mbrojtës Gani Rexha në emër të të pandehurit **Sh.H.2.**, me datë 11 shtator 2014;
- Avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit **I.H.1.**, dhe
- Avokati mbrojtës Bajram Tmava në emër të të pandehurit **N.Q.**.

Avokati mbrojtës Gani Rexha në emër të të pandehurit **Sh.H.2.**, në përgjigjen e tij deklaron se Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar në fakte dhe prova të cilat janë vlerësuar me kujdes. Ai i propozon Gjykatës së Apelit që të hedh poshtë ankesën e prokurorit si të pabazuar dhe të pranoj Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Avokati mbrojtës Mahmut Halimi në emër të të pandehurit **I.H.1** në përgjigjen e tij deklaron se pretendimet e dhëna nga prokurori në ankesën e tij lidhur me të pandehurin **I.H.1.** janë të pasakta. Gjykata me të drejtë ka sqaruar mungesën e besueshmërisë së dëshmitarit lidhur me identifikimin e të pandehurve. Pra, bazuar në deponimet e dëshmitares A dhe B, gjykata e shkallës së parë nuk ka mundur të arrij pragun përtej çdo dyshimi se një identifikim i tillë mund të jetë i saktë dhe i besueshëm. Ai më tej parashtron se pretendimet e prokurorit në ankesën e tij janë të pabazuara. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar me kujdes deponimet e dëshmitarëve dhe ka gjetur kundërtënie që rezultuan në pamundësinë për të besuar këto deponime përtej dyshimit të arsyeshëm. Sa i përket pozitës ushtarake të të pandehurit **I.H.1.**, avokati mbrojtës deklaron se mund të shihet nga kërkesa për pranim të statusit të veteranit të UÇK-së se **I.H.1** ishte vetëm ushtar brenda Zonës Operative të Shalës. Avokati mbrojtës në përgjigjen e tij i

propozon Gjykatës së Apelit që të hedh poshtë ankesën e PSRK-së si të pabazuar dhe të pranoj Aktgjykimin e ankimuar në tërësi.

Avokati mbrojtës Bajram Tmava në emër të të pandehurit **N.Q.** në përgjigjen e tij i referohet fjalimit të tij përfundimtar të paraqitur në gjykim. Ai deklaron se deponimet e dëshmitarëve A, B dhe C janë dëshmi kryesore mbi të cilat është bazuar Aktgjykimin i ankimuar. Deponimet e këtyre dëshmitarëve janë vlerësuar në mënyrë të drejtë nga gjykata e shkallës së parë. Deponimet e dëshmitarëve të tjerë duhet të merren si dëshmi rrethore dhe se këto deponime nuk kanë asgjë të bëjnë me të mbrojturin e tij **N.Q.** Ai më tej deklaron se ka mospërputhje në deklaratën e dëshmitarit A dhe B dhe se kjo dëshmi nuk mbështetet me dëshmi të tjera që gjenden në dosjen e lëndës. Avokati mbrojtës gjen se Aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë është i saktë dhe prandaj i propozon Gjykatës së Apelit që të hedh poshtë këtë ankesë të PSRK-së si të pabazuar dhe të konfirmoj Aktgjykimin e ankimuar në tërësi.

5. Propozimi i Prokurorit të Apelit

Me datë 10 prill 2015, prokurori i Apelit parashtrori propozimin PPA/I-KTZ nr. 45/15. Në propozimin e vet, deklaron se gjykata e shkallës së parë nuk dha vlerësim konciz dhe të logjikshëm për identifikimin dhe dëshminë e njohjes. Më tej thuhet se gjykata e shkallës së parë është dashur që të përcillte qasjen e Tribunalit Penal Ndërkombëtar lidhur me parimet e vlerësimit të identifikimit dhe dëshmisë së njohjes para se të merrte përfundimin e saj për lirim. Ajo i propozon Gjykatës së Apelit që të miratoj ankesat e PSRK-së të përmirësoj Aktgjykimin e kundërshtuar dhe të shpall të gjithë pandehurit fajtor për veprat penale për të cilat ata akuzohen.

6. Kompetenca e Gjykatës dhe Përbërja e Kolegjit

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit mbi Gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Ndarjen e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë - Ligji nr. 03/L-053 i përmirësuar me Ligjin nr. 04/L-273, dhe i sqaruar përmes Marrëveshjes mes Kryesuesit të Eulex-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 18 qershor 2014.

Ligji i përmirësuar nr. 04/L-273 (po ashtu i njohur për publikun si Omnibus Ligji i EULEX-it) në nenin 1.A përcakton se cilat lëndë përbëjnë lëndët në zhvillim e sipër e që bien në juridiksion të gjyqtarëve të EULEX-it. Lënda aktuale qartazi përbën lëndë në procedurë e sipër sipas nenit 1A (1) të ligjit në fjalë. Hetimet lidhur me këtë rast filluan në vitin 2013, aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë u lëshua në maj të vitit 2014 dhe rasti është në pritje e sipër para Gjykatës së Apelit që nga data 2 shkurt 2015.

Me të konfirmuar juridiksionin për këtë lëndë, çështja tjetër që lind është përbërja e kolegjit për një lëndë të EULEX-it në zhvillim e sipër.

Sipas nenit 3.3 të Ligjit nr. 04/L-273 kolegjet për lëndët që bien nën juridiksionin e EULEX-it duhet të jenë përbërje të shumicës së gjyqtarëve të Kosovës nëse Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) nuk vendos që kolegji të jetë i përbërë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Kjo dispozitë dhe kërkesa për një vendim nga KGJK-ja çojnë tek neni 2 i marrëveshjes në mes të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të datës 18 qershor 2014. KGJK-ja përmes kësaj Marrëveshje vendosi se në të gjitha rastet në proces trupi gjykues do të përbëhet me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it dhe “do të vazhdojnë me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it të kolegjit për vazhdim në të gjitha fazat e gjykimit dhe pjesës tjetër të procedurës.” Termi “pjesa tjetër e procedurës” duhet të lexohet si referencë e qartë për procedurën me mjete juridike. Prandaj, dispozita vlen gjithashtu për procedurën e apelit në raste të tilla në proces.

Në përputhje me bazën ligjore të përmendur më lart, kolegji i apelit në rastin në fjalë, prandaj është krijuar në mënyrë të saktë prej dy gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtari kosovar të Gjykatës së Apelit.

Në seancën e apelit të mbajtur më 05 prill 2016, avokati mbrojtës Mahmut Halimi kundërshtoi përbërjen e kolegjit duke aluduar se kolegji i Gjykatës së Apelit në këtë rast duhet të përbëhet nga dy gjyqtarë kosovarë të Gjykatës së Apelit dhe një gjyqtar të EULEX-it.

Pas vërejtjeve të avokatit mbrojtës Mahmut Halimi, kolegji u tërhoq për një këshillim të shkurtër. Kolegji me shumicë votash erdhi në përfundim se kolegji është kompetent që të vendosë mbi këtë ankesë në pajtim me nenin 17 dhe nenin 18 të Ligjit për Gjykatat (Ligji nr. 03/L-199).

Sipas bazës ligjore të përmendur më lart, kolegji i apelit në rastin në fjalë prandaj është përbërë nga dy gjyqtarë të Eulex-it dhe një gjyqtar kosovar të Gjykatës së Apelit.

7. Meritat e rastit

a) Lirimi i të pandehurve I.H.1 dhe N.Q.

Në rastin në fjalë, kolegji i Gjykatës së Apelit së pari do të diskutojë lirimin e të pandehurve **I.H.1** dhe **N.Q.**.

Të dy të pandehurit janë akuzuar për veprën penale të Krimeve të luftës kundër popullatës civile nën akuza të shumta. Pas seancave publike, të pandehurit janë liruar nga të gjitha akuzat nga gjykata e shkallës së parë. Prokuroria kanë paraqitur ankesë duke pretenduar në shkelje esenciale të procedurës kriminale, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Në lidhje me të pandehurin **I.H.1** dhe **N.Q.**, gjykata e shkallës së parë i shpallë të dytë të pafajshëm sepse nuk ishte vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **I.H.1** dhe i pandehuri **N.Q.**, në cilësinë e tyre si ushtarë të UÇK-së, në bashkëkryerje me njëritjetrin dhe një ushtar tjetër të UÇK-së, deri më tani të identifikuar si "**H**", **cenuan integritetin trupor dhe shëndetin e dëshmitares A**, një femër civile shqiptare nga Kosova dhe **torturuan dëshmitaren B**, një femër civile shqiptare nga Kosova, duke e rrahur atë në mënyrë të vazhdueshme dhe duke e detyruar atë që të shkruante dhe të pranonte rrejshëm lidhur me gjoja bashkëpunimin e saj me autoritete serbe. Nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **I.H.1** ka marrë pjesë në krim duke përdorur autoritetin e tij për të mbajtur viktimat në dispozicion të kryesve të drejtpërdrejtë të veprës penale dhe duke u lejuar atyre që të kryejnë vepra penale, në fshatin V. (Komuna e M.), në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998/fillim të vitit 1999.

Pretendimi kryesor i bërë nga prokurori në ankesën e tij është se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar sa duhet dëshmitë e dëshmitarëve A, B dhe C.

Kolegji i Gjykatës së Apelit e konsideron aktgjykimin e kundërshtuar në lidhje me të pandehurit **I.H.1** dhe **N.Q.** mjëftueshëm të arsyetuar. Identifikimi i këtyre dy të pandehurve nuk është vërtetuar përfundimisht, prandaj pjesëmarrja e tyre në krimet në fjalë nuk është vërtetuar. As dëshmitarja A, e as dëshmitarja B nuk kanë mundur të dëshmojnë pozitivisht për pjesëmarrjen e këtyre dy të pandehurve në ngjarjet e përshkruara në aktakuzë. Në të njëjtën kohë asnjë dëshmi tjetër nuk mund t'i lidhë përfundimisht këta 2 të pandehur me krimet në fjalë.

Për arsyet e cekura më lart, kolegji i Gjykatës së Apelit hedh poshtë pretendimet e prokurorisë në lidhje me të pandehurit **I.H.1** dhe **N.Q.** dhe konfirmon aktgjykimin e kundërshtuar të Gjykatës Themelore të Mitrovicës siç është paraqitur në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

8. Shkeljet esenciale të pretenduara të KPP-së

Prokurori në ankesën e tij paraqet se aktgjykimin nuk është hartuar në pajtim me nenin 370 të KPP-së prandaj në mënyrë esenciale shkel nenin 384 (1) 1.12) të KPP-së.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas kësaj dispozite, pasi që nuk ka deklaruar në mënyrë të qartë dhe të shterueshme, se cili fakt është vërtetuar apo nuk është vërtetuar në lidhje me inskenimin e gjoja ekzekutimit. Gjykata nuk ka siguruar baza të mjaftueshme për të sqaruar sigurinë e marrëdhënies së dashurisë në mes të **H.2.** dhe dëshmitares A.

PSRK-ja më tej paraqet në ankesën e tyre se konstatimet në lidhje me përdhunimin janë paraqitur pa ndonjë arsyetim transparent dhe të plotë.

9. Konstatimet e kolegjit në lidhje me inskenimin e gjoja ekzekutimit dhe të pandehurin I.H.1.

Në aktgjykimin e kundërshtuar gjykata deklaroi se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri në cilësinë e tij si ushtar i UÇK-së **trajtoi në mënyrë çnjerëzore dëshmitaren A dhe dëshmitaren B duke e inskenuar gjoja ekzekutimin** me ç' rast i pandehuri i shtinte viktimat që të binin në gjunjë dhe pastaj shkrepnin të shtëna armësh prapa shpinës së tyre, në një vend të papërcaktuar mes fshatrave të V. dhe L., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998 fillim të vitit 1999. Si vërejtje paraprake ky kolegji vëren se Gjykata e Apelit zbaton në përgjithësi parimin që kërkohet të ofrojë njëfarë shkalle të konsiderueshme të respektit ndaj konstatimit të faktit të trupit gjykues pasi ka dëgjuar dëshminë dhe është në pozitën më të mirë për të vlerësuar peshën dhe vlerën e saj. Në rastin në fjalë megjithatë aktgjykimit i mungon çfarëdo deklarate e fakteve në lidhje me inskenimin e gjoja ekzekutimit. Nga argumentet nuk mund të shihet nëse gjykata ka konstatuar nëse inskenimi i gjoja ekzekutimit ka ndodhur fare dhe nëse po nëse i pandehuri **I.H.1** është identifikuar të jetë pjesë e ngjarjes së pretenduar. Pra, gjykata nuk e ka gjykuar plotësisht lëndën e akuzës, që është në shkelje të nenit 384 (1) 1.7) 1.12) në lidhje me nenin 370 dhe nenin 7 të KPP-së.

10. Vërtetim i gabueshëm ose jo të plotë i gjendjes faktike të pretenduar

PSRK-ja në ankesën e tyre paraqesin se gjykata gabimisht ka vërtetuar identifikimin e dëshmisë së të pandehurit **S.S.** në lidhje me akuzën siç përcaktohet në aktakuzën e PSRK-së dhe përfshirjen e të pandehurit **Sh.H.2.** në rastin e përdhunimit. PSRK-ja në ankesën e tyre pretendojnë gjithashtu se gjykata nuk i ka lejuar prokurorisë që të kryej ndonjë identifikim në gjykatë, në veçanti identifikimin e **S.S.t.** Duke e bërë këtë, gjykata ka shkelur esencialisht nenin 384 (2) 2.1) dhe ka shkelur nenin 7 të KPP-së.

11. Identifikimi i të pandehurit S.S. dhe përfshirja e të pandehurit Sh.H. në rastin e përdhunimit

I pandehuri **S.S.** është akuzuar dhe liruar për cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të dëshmitareve A dhe B, dy femra civile shqiptare nga Kosova, duke i rrahur ato në mënyrë të vazhdueshme. Ngjarja pretendohet të ketë ndodhur në L., Komuna e S., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998/fillim të vitit 1999, ku i pandehuri ishte një pjesëtar i rangut të lartë të UÇK-së.

I akuzuari **Sh.H.2.** nuk është shpallur fajtor sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri e ka përdhunuar dëshmitaren A, një femër civile shqiptare nga Kosova, të ndaluar nga UÇK-ja, duke patur marrëdhënie seksuale me të kundër dëshirës së saj, në fshatin V. (komuna e M.), në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998/fillim të vitit 1999'. Ai është liruar gjithashtu nga akuza e torturimit të dëshmitares B, duke e rrahur atë në mënyrë të vazhdueshme me mjete të ndryshme.

Përfshirja e pretenduar e të pandehurit **S.S.** shtrohet nga dëshmitë e dëshmitareve A² dhe B³ si dëshmitare të drejtpërdrejta dhe viktima në këtë rast. Mund të lexohet se të dyja dëshmitaret janë të sigurta në lidhje me identitetin e të pandehurit **S.S.**. Megjithatë, gjykata e shkallës së parë deklaroi se nuk ka kurrfarë prove të drejtpërdrejta të vendit se ku kanë ndodhur ngjarjet si dhe nuk ka pasur kurrfarë prove të besueshme se dëshmitaret kanë udhëtuar ndonjëherë për në L. ose se dëshmitaret kanë pasur kontakt të drejtpërdrejta me të pandehurin **S.** Në këtë aspekt ky kolegji e gjen të pakuptueshëm argumentimin e Gjykatës Themelore.

Nuk ka kurrfarë analizimi në aktgjykim që do t'i ndriçonte një lexuesi të paanshëm se pse dëshmitë e këtyre dy dëshmitareve nuk janë besuar fare sa i përket identifikimit të **Z S.** Përveç kësaj nuk ka ndonjë sqarim të arsyeshëm sa i përket asaj se pse nuk është lejuar identifikimi në gjykatë i **Z. S.** Nuk ka kurrfarë ndalese kundër identifikimit në gjykatë në kodin e procedurës penale dhe nuk ka kurrfarë arsye formale për ta refuzuar atë. Është një çështje plotësisht tjetër nëse rezultati i këtij identifikimi do të besohet apo jo, ai do të vlerësohet si çdo provë tjetër, ndaras dhe në tërësinë e të gjitha provave.

Ky kolegji i shqyrton plotësisht të gjitha dyshimet e shprehura si nga gjykata e shkallës së parë ashtu dhe nga mbrojtja ndaj vlerës provuese të një identifikimi të tillë, por kjo mund të vlerësohet kur të kryhet identifikimi dhe vetëm pas kësaj rezultatet e tij vlerësohen individualisht dhe në tërësinë e të gjitha provave të administruara.

² Dëshmia e dëshmitares A gjatë seancës së datës 22 prill 2014;

³ Dëshmia e dëshmitares B gjatë seancës së datës 24 prill 2014;

Kolegji gjithashtu e gjen të çuditshme faktin se aq shumë rëndësi i është dhënë argumentit se dëshmitaret e drejtpërdrejta gabojnë shumë shpesh në dëshmitë e tyre në lidhje me ngjarjet e fundit që ato kanë qenë dëshmitare.

Kolegji pajtohet me vlefshmërinë e përgjithshme të argumentit se një qenie njerëzore, vullnetarisht apo në mënyrë jo të vullnetshme, gabon shpesh kur përshkruan ngjarje në të cilat ai/ajo ka qenë dëshmitar/e dhe aq më tepër kur ngjarjet ishin stresuese, dramatike dhe/ose dëmtuese. Dihet se dëshmitë e dëshmitarëve janë shpesh jo të sakta dhe të pasigurta, sepse ato bazohen në perceptimet subjektive, të cilat i nënshtrohen ndryshimeve të ndryshme të shkaktuara nga gabimi, vetëmashtrimi, sugjerimi apo dëshira për të gënjyer. Përveç kësaj ky kolegji pajtohet që identifikimi i dëshmitarit duhet të trajtohet gjithmonë me kujdes të madh sidomos në rastet kur dëshmitari për shembull e kishte vështruar shumë shkurt kryesin, për shkak se një dëshmitar i tillë nëse është i sinqert mund të jetë shumë bindës. Megjithatë, kjo nuk është relevante për rastin në fjalë, sepse dëshmitaret jo vetëm që i kanë hedhur një shikim të shkurtër të pandehurit Selimi, por kanë pasur mundësinë që ta shohin atë shumë mirë për shumë më tepër se vetëm një moment.

Më e rëndësishmja, paragjykimi se një dëshmi merret si e mirëqenë e pabesueshme, do të thotë se vështirë ndonjëherë ose ndonjë deklaratë e dëshmitarit do të konsiderohej se mban vlerë provuese në procedurë penale. Ky kolegji nuk pajtohet me një mundësi të tillë dhe thekson se deklaratat e dëshmitarëve mund të kenë të njëjtën vlerë provuese (me kufizimet, e parapara në ligj, *psh.* neni 262 i KPP-së) si çdo provë tjetër në procedurë penale dhe pesha e tyre ndaj lirit apo dënimit duhet gjithmonë të analizohet me aq kujdes si çdo provë tjetër. Lëre më se në rastet e caktuara dëshmitar i krimit është vetëm viktima dhe kryesi dhe pastaj e vetmja provë në dispozicion është dëshmia e kësaj viktime të veçantë.

Duke refuzuar madje për të kryer identifikimin në gjykatë Gjykata Themelore ka shkelur nenin 7 (1) të KPP-së duke i vënë gjykatës obligim që të vërtetojë faktet që janë të rëndësishme për nxjerrjen e një vendimi të ligjshëm.

Duke respektuar parimin e prezumimit të pafajësisë dhe pa paragjykuar rezultatin e vendimit, kolegji është i mendimit se në rastin në fjalë, duhet të kryhet identifikimi në gjykatë i të pandehurit S.

Më tej është e pakuptueshme se pse aq shumë rëndësi i është dhënë paqartësisë lidhur me vendin ku pretendohet ta kenë parë dëshmitaret Z. S.(d.m.th. L.) por nuk i është kushtuar kurrfarë rëndësie se çfarë ato saktësisht kanë dëshmuar në lidhje me të pandehurin – ku ishte ulur ai, çfarë po pinte ai, çfarë po thoshte ai, çfarë kishte bërë ai, etj. Kjo e bënë

qëndrimin e Gjykatës Themelore të paqartë dhe të vështirë për t'u kuptuar, në këtë mënyrë shkelja e nenit 370 (7) që, siç përmendet më lart, kërkon nga gjykata që të japin arsyet për pranimin e disa fakteve si të provuara ose jo.

Lidhur me rastin në fjalë për Gjykatën e Apelit mbetet e pakuptueshme për shembull se pse deklaratat e dëshmitares A në lidhje me rrëmbimin janë besuar, por në lidhje me ngjarjet në V. dhe pastaj gjoja në L. janë konsideruar të pabesueshme. Nuk ka asnjë analizë që do të sqaronte se pse në lidhje me një sërë ngjarjesh (rrëmbimi), A ishte plotësisht e besueshme dhe në të kundërtën, plotësisht e pabesueshme për një sërë tjetër ngjarjesh (ato në V. dhe L.). Ekzistimi i një marrëdhënie intime në mes të **H.2.** dhe dëshmitares A para luftës nuk e justifikon një qasje të tillë.

Nuk është përmendur fakti se dëshmitaret A dhe B nuk kanë insistuar në identifikimin e të pandehurit **H.1.** për shembull (fq. 32 dhe fq. 41 e procesverbalit të seancës së datës 22 prill 2014 dhe faqe 11 e procesverbalit të datës 25 prill) që çoi në lirimin e tij dhe se si kjo mund të pasqyrojë apo jo kredibilitetin e tyre.

Një deklaratë tjetër faktike (pika 10 në faqe 11 të aktgjykimit – versioni në anglisht), që do të thotë se nuk ka qenë e qartë nëse marrëdhënia seksuale në V. në mes të pandehurit **H.2.** dhe dëshmitares A ka ndodhur pa pëlqimin e saj, e bënë shumë të vështirë të kuptohet se çfarë saktësisht është qëndrimi i Gjykatës Themelore në lidhje me ngjarjet atje (shkelje e nenit 370 (7), në lidhje me deklaratat e fakteve dhe bazat për të).

Nga njëra anë, gjykata pozitivisht pranon se A ishte kidnapuar nga **H.2.**; atëherë padyshim pozitivisht pranon se ka pasur marrëdhënie deri sa ajo ishte e rrëmbyer dhe pastaj në kundërshtim me logjikën e shëndoshë supozon se këto marrëdhënie mund të kenë ndodhur me pëlqimin e dëshmitares A, vetëm sepse këta të dy, dëshmitarja A dhe i pandehuri **H.2.** kishin pasur marrëdhënie intime para ngjarjeve në fjalë. Është absurde edhe të supozojmë se dikush i zënë rob, i nënshtruar vullnetit të robëruesve do të ishte në gjendje që në mënyrë të vlefshme të shprehte pëlqimin. Historia e krimit njeh raste të viktimave të lidhjes “vullnetare” me robëruesit e tyre dhe zhvillimin e ndjenjave për ta, e ashtuquajtura sindroma e Stokholmit. Megjithatë, nuk ka asnjë arsye për të besuar se ky ishte një rast i tillë, pavarësisht ndonjë raportit të mëparshëm intim në mes të **H.2.** dhe A, por edhe nëse kemi një rast të tillë, një lidhje traumatike e këtij lloji do të ishte një gjendje psikologjike dhe çfarëdo pëlqimi i shprehur nga viktimat në rrethana të tilla vështirë se do të konsiderohej ligjërisht i vlefshëm.

Përveç se ngjarjet kanë ndodhur gjatë kohës së luftës, d.m.th. në një mjedis shtrëngues dhe pëlqimi në rrethana të tilla do të ishte i pavlefshëm. Referencë i është bërë definicionit të përdhunimit, dhënë nga TPNR në rastin e Prokurorit v. Jean-Paul Akayesu.

Duke i shtuar ngatërrimit në lidhje me atë se çfarë në të vërtetë ka pranuar gjykata të ketë ndodhur në V., duhet theksuar se në një vend tjetër të aktgjykimit thuhet se gjykata nuk mund të gjejë ndonjë dëshmi objektive se përdhunimi (fjalë për fjalë: “ajo vepër penale”) të ketë ndodhur ndonjëherë (faqe 14 të versionit në anglisht, fjalia e fundit para “Rrëmbimit në kafene”). Kjo e bënë edhe më të vështirë për të kuptuar se çfarë ka pranuar gjykata si fakt: a ka pranuar gjykata se ka pasur marrëdhënie apo nuk ka pasur fare?

Përfundimisht është e parëndësishme nëse i pandehuri **H.2.** ka pasur ndonjë lidhje me ushtrinë.

Duke respektuar parimin e *prezumimit të pafajësisë* dhe pa paragjykuar rezultatin e vendimit, kolegji është i mendimit se në rastin në fjalë, i pandehuri **Sh.H.2.** ka mundur të ketë kryer një krim lufte, pasi që nuk kërkohet pozita ushtarake e kryesit.

Për të përcaktuar nëse veprimet e të pandehurit përbëjnë një krim lufte, në përputhje me rrethanat duhet të adresohen elementet e mëposhtme:

- A kishte një konflikt të armatosur që po zhvillohej në Kosovë në atë kohë, në fshatin V., Komuna e M., në një datë të papërcaktuar në fund të vitit 1998/fillim të vitit 1999;
- Dhe nëse po, cilat kanë qenë normat e zbatueshme që rregullonin, konfliktin e atëhershëm të armatosur (ishte konflikt i armatosur i një natyre ndërkombëtare apo jo-ndërkombëtare);
- A ishte dëshmitarja A person i mbrojtur sipas të drejtës ndërkombëtare;
- A ka pasur një lidhje *shkakësore* në mes të konfliktit të armatosur dhe veprës penale;

Provat dhe rrethanat e çështjes në fjalë përbushin të gjitha kërkesat e përmendura më lart.

12. Vërejtjet përfundimtare

Nga arsyet e sipër përmendura, aktgjykimi i kundërshtuar, në pjesët siç është cekur më lart, përmban shkelje esenciale të dispozitave të KPP-së dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike. Për shkak të mos vërtetimit të fakteve materiale të gjykatës së shkallës së parë, kolegji i Gjykatës së Apelit ia kthen rastin gjykatës kompetente, që do të thotë Gjykatës Themelore të Mitrovicës, për rigjykim.

Gjatë rigjykimit, gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në përputhje me vërejtjet e përmendura më lart dhe të vazhdojë në përputhje me nenin 406 të KPP-së, në lidhje me

pjesëmarrjen e pretenduar të të pandehurit **I.H.1** në inskenimin e gjoja ekzekutimit të dëshmitareve A dhe B; për të lejuar kryerjen e identifikimit në gjykatë të të pandehurit S.S. në lidhje me ngjarjet në L. gjatë periudhës kohore siç është specifikuar në aktakuzë dhe përfshirjes së të pandehurit **Sh.H.2.** në ngjarjen e përdhunimit siç është cekur në aktakuzë.

Në lidhje me të pandehurit **I.H.1** dhe **N.Q.** konfirmohet aktgjykimi P. nr. 941/13 i Gjykatës Themelore të Mitrovicës nxjerrë më 29 maj 2014.

Për arsyet e cekura më lart, në pajtim me nenin 389 të KPP-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv.

Shpenzimet e procedurës penale për të gjithë të pandehurit do të paguhen nga mjetet buxhetore.

Kryetarja e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova, gjyqtare e EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Fillim Skoro, gjyqtar kosovar i Gjykatës së Apelit

Piotr Bojarczuk, gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtësja

Vjollca Kroçi - Gërxhaliu, këshilltare ligjore e EULEX-it

GJYKATA E APELIT

PAKR 39/2015

5 prill 2016